

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH

01.Nr.06-61/1

07.05.2009

D r a g a s h

Në bazë të nenit 40.2 shkronja a) e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me nr.03/L-040 nenit 32.2 , të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve Nr.02/L-37 ,dhe nenit 32.2. të Statutit të komunës së Dragashit , me qëllim të respektimit të identitetit gjuhësor të gjithë personave dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi për të gjitha komunitet që të shprehin dhe të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor , Kuvendi komunal ne Dragash në seancën e vet të rregullt të mbajtur më datën 07.05. 2009 , miraton këtë :

**RREGULLORE
PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË ORGANET E
ADMINISTRAËS TË KOMUNËS SË DRAGASHIT**

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

1.1. Qëllimi i kësaj Rregullore është që të sigurojë:

1.2. Përdorimin e gjuhëve zyrtare , si dhe të gjuhëve të komuniteteve , gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në shërbimin civil komunal të Dragashit , në ndërmarrje dhe organizata tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike.

1.4 Të drejtën e të gjitha komuniteteve të Komunës të Dragashit , për të ruajtur , mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor.

Neni 2.

2.1 Në Komunën e Dragashit si gjuhë zyrtare aplikohen ose njihen:

- Gjuha Shqipe ,
- Gjuha Serbe dhe
- Gjuha Boshnjake

2.

2.2. Në Komunë aplikimi i gjuhës serbe dhe boshnjake bëhet në formë të shkruar me alfabetin latin .

2.3. Gjuhët zyrtare përdorën në baza të barabarta në takimet dhe në punët e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale.

Neni 3.

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtët të komunikojnë në gjuhën e tyre me organet dhe shërbimet civile të komunës.

Neni 4

Të gjitha dokumentet zyrtare , të lëshuara nga organet e administratës dhe institucionet tjera komunale duhen të jenë në gjuhën e pakës

Neni 5.

Gjuhë e palës konsiderohet gjuha me të cilën paraqitet pala, ajo gjuhë me të cilën pala i është drejtuar organit të administratës ose shërbimeve të komunës.

Neni 6.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij dhe punët e organeve ekzekutive komunale , zhvillohen duke aplikuar përkthimet simulant dhe nëpërmes përkthyesit , atëherë kur nuk ekzistojnë kushtet teknike për përkthim simulant , por nëse kjo kërkohet nga pjesëmarrësit në mbledhje.

Neni 7.

Shënimet e takimeve dhe shënimet zyrtare të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale , regjistrat publik dhe dokumentet tjera zyrtare , mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.

Neni 8

Organet komunale duhet të sigurojnë përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare si dhe të mundësojnë përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare nga zyrtarët dhe punëtorët e tyre.

3.

Neni 9

9.1. Aktet Ligjore dhe nënligjore që miratohen nga organet komunale ,nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës , versionet e zyrtare të akteve të hartuara në gjuhët zyrtare janë të barabarta .

9.2. Shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrat e rrugëve , rrugicave dhe të vendeve tjera publike,paraqiten ne gjuhët zyrtare që aplikohen ne komunë

Neni 10

Anëtarët e komuniteteve , gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare ,kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre në punë dhe në takime të organeve përfaqësuese të komunës dhe komiteteve të tyre si dhe në takimet publike të organizuara nga komuna.

Neni 11.

Kjo Rregullore hynë në fuqi 8. ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit komunal në Dragash .

KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL,

Lulzim Rifaj